Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

SHKËMBIMI TREGTAR I PRODUKTEVE BUJQËSORE 2014-2018

Nëntor, 2019

Shkëmbimi tregtar i produkteve bujqësore 2014-2018

Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Nëntor, 2019

Parathënie

Në publikimin "Shkëmbimi tregtar për prodhime bujqësore 2014-2018" është bërë një përmbledhje e të dhënave të shkëmbimit tregtar të Kosovës me vende tjera, që përmban tabela të cilat pasqyrohen me figura dhe prezantojnë gjendjen për tregtinë e jashtme të Kosovës për periudhën 2014-2018, si dhe disa të dhëna krahasuese për vitet në fjalë.

Këto tabela kanë të bëjnë me eksportin dhe importin sipas qarkullimit të mallrave bazuar në Sistemin e Harmonizuar Doganor për kapitujt 01-24 (produktet bujqësore), produktet më të importuara-eksportuara sipas kapitujve, grupet e shteteve si dhe shtetet prej nga është importuar dhe eksportuar më tepër në pesë vitet e fundit (2014-2018).

Është bërë përpjekje që të pasqyrohen kryesisht produktet që bëjnë pjesë në kapituj të ndryshëm të sistemit të harmonizuar doganor 01-24, të cilat produkte kanë pasur eksport ose import më tepër, konkretisht ato që kanë potencial të prodhohen në vendin tonë.

Përveç produkteve bujqësore janë përfshirë edhe informata për kapitullin 31, ku bëjnë pjesë plehrat dhe kapitulli 38 ku klasifikohen pesticidet.

Informatat e përfshira në publikimin për tregtinë e jashtme bazohen në të dhënat që merren nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Tabela e përmbajtjes

Parathënie **2**

1 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore **5**

1.1 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve **6**

1.1.1 Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve 6

1.1.2 Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve 8

1.2 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore sipas shteteve **10**

1.2.1 Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve 10

1.2.2 Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve 11

1.3 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve **12**

1.3.1 Eksporti i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve 12

Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve të BE-së 13

Eksporti i produkteve bujqësore për shtetet tjera (jashtë BE-së dhe CEFTA-s) 14

1.3.2 Importi i produkteve bujqësore sipas gruperve të shteteve 14

Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve të CEFTA-s 15

Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve të BE-së 15

Importi i produkteve bujqësore për shtetet tjera (jashtë BE-së dhe CEFTA-s) 16

1.3.3 Bilanci tregtar sipas grupeve të shteteve 16

1.4 Produktet bujqësore (kapitujt) më të eksportuara dhe importuara **17**

1.4.1 Kapitujt që kanë pasur vlerë më të madhe të eksportit në vitin 2018 17

1.4.2 Kapitujt që kanë pasur vlerë më të madhe të importit në vitin 2018 18

1.5 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore për secilin kapitull sipas viteve **19**

1.5.1 Eksporti dhe importi për "Kafshët e gjalla" (kapitulli 01) 19

1.5.2 Eksporti dhe importi për "Mishin dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve" (kapitulli 02) 20

1.5.3 Eksporti dhe importi për "Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore" (kapitulli 03) 21

1.5.4 Eksporti dhe importi për "Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër" (kapitulli 04) 22

1.5.5 Eksporti dhe importi për "Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër" (kapitulli 05) 23

1.5.6 Eksporti dhe importi për "Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative" (kapitulli 06) 24

1.5.7 Eksporti dhe importi për "Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve" (kapitulli 07) 25

1.5.8 Eksporti dhe importi për "Pemët dhe arroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit" (kapitulli 08) 26

1.5.9 Eksporti dhe importi për "Kafe, çaj, krem dhe erëza" (kapitulli 09) 27

1.5.10 Eksporti dhe importi për "Drithërat" (kapitulli 10) 28

1.5.11 Eksporti dhe importi për "Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri" (kapitulli 11) 29

1.5.12 Eksporti dhe importi për "Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere" (kapitulli 12) 30

1.5.13 Eksporti dhe importi për "Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale" (kapitulli 13) 31

1.5.14 Eksporti dhe importi për "Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër" (kapitulli 14) 32

1.5.15 Eksporti dhe importi për "Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore" (kapitulli 15) 33

1.5.16 Eksporti dhe importi për "Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore" (kapitulli 16) 34

1.5.17 Eksporti dhe importi për "Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij" (kapitulli 17) 35

1.5.18 Eksporti dhe importi për "Kakao dhe përgatitjet prej kakaos" (kapitulli 18) 36

1.5.19 Eksporti dhe importi për "Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastiçerisë apo prej brumërave" (kapitulli 19) 37

1.5.20 Eksporti dhe importi për "Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroreve apo pjesëve të tjera të bimëve" (kapitulli 20) 38

1.5.21 Eksporti dhe importi për "Përgatitje të ndryshme të ngrënshme" (kapitulli 21) 39

1.5.22 Eksporti dhe importi për "Pijet, alkoolet dhe uthulla" (kapitulli 22) 40

1.5.23 Eksporti dhe importi për "Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë" (kapitulli 23) 41

1.5.24 Eksporti dhe importi për "Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit" (kapitulli 24) 42

1.6 Importi i pesticideve dhe plehrave minerale 43

1.6.1 Importi i pesticideve 43

1.6.2 Importi i plehrave minerale 44

Lista e tabelave 45

Lista e figurave 47

1 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore

Vlera e eksportit të produkteve bujqësore për kapitujt 01-24 ka pasur rritje të vazhdueshme. Në vitin 2014 vlera e eksportit ishte 39.4 mil. €. Kjo rritje ka vazhduar edhe në vitet në vijim, deri sa në vitin 2018 kjo vlerë arriti në 64 mil. €, ku paraqitet një rritje në krahasim me vitin 2014 për 62.5%.

Po ashtu ritëm shumë më të madh të rritjes ka pasur vlera e importit të produkteve bujqësore që është rritur me shpejtësi në periudhën 2014-2018. Kështu që në vitin 2014 kjo vlerë ishte 616.1 mil. €, pasuar me rritje edhe në vitet në vijim, ndërsa në vitin 2018 arriti vlerën 712.3 mil. €. Prandaj nëse e krahasojmë vlerën e importit të vitit 2014 me atë 2018 del se ka pasur rritje për 15.6%.

Tabela 1: Eksporti dhe Importi i produkteve bujqësore (01-24), në '000 €

Viti	Eksporti	Importi	Bilanci tregtar
2014	39,359	616,118	-576,759
2015	41,683	633,702	-592,019
2016	45,205	658,730	-613,525
2017	61,336	694,517	-633,180
2018	63,950	712,314	-648,364

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 1: Eksporti (majtas) dhe Importi (djathtas) për produktet bujqësore (01-24), në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Bilanci tregtar për produktet bujqësore për periudhën 2014-2018 ishte negativ, edhe pse eksporti ka shënuar rritje, mirëpo në të njëjtën kohë ka pasur rritje shumë më të madhe të vlerës së importit. Në vitin 2014 bilanci tregtar shënoi vlerën -576.8 mil. €, kurse në vitin 2017 ky bilanc ishte -633.2 mil. €, e që në vitin 2018 pasoi prapë me thellim të bilancit negativ për 2.4% në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017.

Figura 2: Bilanci tregtar për produktet bujqësore, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.1 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve

1.1.1 Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve

Krahasuar me vitin 2017, në vitin 2018 ka pasur ndryshime në vlerë të eksportit të produkteve bujqësore. Dallime më të mëdha vërehen në produktet bujqësore nga kapitulli 15 me rritje 91.7%, kapitulli 21 kishte rritje për 73.8% dhe kapitulli 12 që po ashtu kishte rritje 55%. Ndërsa rënie në vlerë ka pasur në këto kapituj: Kapitulli 11 në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 për 43.3%, kapitulli 03 për 36,1% dhe gjithashtu kapitulli 02 për 30.7%.

Tabela 2: Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve, në '000 €

Kodet dhe përshkrimi		2017	2018	Ndryshimi (2018-2017)	Ndryshimi (në %)
01	Kafshët e gjalla	-	17	17	
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	183	127	-56	-30.7
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	172	110	-62	-36.1
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	492	471	-21	-4.2
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	-	-	-	-
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	165	226	61	36.7
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	4,899	5,636	737	15
08	Pemët dhe arroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	8,616	8,781	165	1.9
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	3,677	3,971	294	8
10	Drithërat	262	386	124	47.3
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	4,254	2,411	-1,842	-43.3
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	1,558	2,414	857	55
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	-	-	-	-
14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	-	1	1	
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	179	343	164	91.7
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	618	776	158	25.6
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	652	712	61	9.3
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	1,909	1,763	-146	-7.6
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastiçerisë apo prej brumërave	1,925	1,893	-32	-1.7
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroreve apo pjesëve të tjera të bimëve	6,171	4,507	-1,664	-27
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	352	612	260	73.8
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	24,194	27,565	3,371	13.9
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	1,060	1,228	168	15.9
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	-	-	-	-
Gjithsej		**61,336**	**63,950**	**2,614**	**4.3**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 3: Eksporti i produkteve bujqësore sipas kapitujve në vitin 2018, në mil. €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.1.2 Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve

Rënie më të madhe në vlerë të importit të produkteve bujqësore në vitin 2018, krahasuar me atë 2017 është shënuar në kapitullin e 17 për 20.4%, kapitullin 11 për 15.1% si dhe në kapitullin 6 për 5.8%. Rritje më të madhe në vlerë të importit në vitin 2018 krahasuar me vitin paraprak ka pasur në kapitujt në vijim: kapitulli 13 për 45.2%, kapitulli 14 për 54% dhe kapitulli 01 për 42.6%.

Tabela 3: Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve, në '000 €

Kodet dhe përshkrimi		2017	2018	Ndryshimi (2018-2017)	Ndryshimi (në %)
01	Kafshët e gjalla	10,873	15,502	4,628	42.6
02	Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve	61,986	64,878	2,892	4.7
03	Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore	2,640	2,999	359	13.6
04	Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	45,069	47,672	2,603	5.8
05	Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	915	986	71	7.7
06	Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative	4,847	4,566	-281	-5.8
07	Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve	22,934	24,742	1,808	7.9
08	Pemët dhe arroret e ngrënshme; lëvozhga e agrumeve ose shalqirit dhe pjeprit	35,069	34,415	-653	-1.9
09	Kafe, çaj, krem dhe erëza	33,629	31,163	-2,467	-7.3
10	Drithërat	31,697	36,434	4,737	14.9
11	Produktet e industrisë bluajtëse; maja e elbit apo drithërave tjera; niseshte; inulinë; gluten gruri	10,822	9,187	-1,635	-15.1
12	Farat vajore dhe frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta të ndryshme; bimët industriale apo medicinale; kashta dhe foragjere	9,409	10,703	1,294	13.8
13	Lënda e trashë ngjitëse nga të çarat e drunjëve; rrëshira, dhe lëngje dhe ekstrakte të tjera vegjetale	368	534	166	45.2
14	Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër	7	10	4	54.0
15	Vajra dhe yndyrat bimore apo shtazore dhe produktet e nxjerra nga to; yndyrat e ngrënshme të përgatitura; dyllet bimore apo shtazore	28,362	27,930	-432	-1.5
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut apo prej krustaceve, molusqeve apo kafshëve të tjera jokurrizore ujore	27,338	26,677	-661	-2.4
17	Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej tij	35,568	28,296	-7,272	-20.4
18	Kakao dhe përgatitjet prej kakaos	23,485	23,888	403	1.7
19	Përgatitjet prej drithërave, miellit, niseshtes apo qumështit; produktet e pastiçerisë apo prej brumërave	62,925	64,618	1,693	2.7
20	Përgatitjet prej perimeve, frutave, arroreve apo pjesëve të tjera të bimëve	26,373	27,321	947	3.6
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënshme	64,124	68,105	3,981	6.2
22	Pijet, alkoolet dhe uthulla	75,220	77,152	1,932	2.6
23	Mbetjet nga industritë ushqimore; Ushqim foragjer i përgatitur për kafshë	18,736	19,688	952	5.1
24	Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit	62,122	64,848	2,726	4.4
Gjithsej		694,517	712,314	17,798	2.6

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Sa i përket strukturës së mallrave, në fushën e produkteve bujqësore, nga gjithsej vlera e importit në Kosovë, rreth 68% janë produkte të përpunuara. Në këtë kontekst, është e nevojshme të shtohet se faktori që ndikon ndjeshëm në këto shifra është importi nga kapitulli 22 në vlerë prej 77.1 mil. €, kapitulli 21 në vlerë prej 68.1 mil. €, vijuar nga kapitulli 02 në vlerë prej 64.9 mil. €, kapitulli 19 dhe kapitulli 24 që kishin vlerë 64.6 mil. € dhe 64.8 mil. €, respektivisht, si dhe vlera e kapitujve tjerë të prezantuar në figurën në vijim.

Figura 4: Importi i produkteve bujqësore sipas kapitujve në vitin 2018, në mil. €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.2 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore sipas shteteve

1.2.1 Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve

Vlerë më e madhe e eksportit të produkteve bujqësore në vitin 2018 ka qenë në këto shtete: Shqipëri 21.3 mil. €, vijuar nga Gjermania dhe Maqedonia ku vlera e eksportit ishte 8.3 mil. € dhe 8 mil. € respektivisht, si dhe në Serbi 6.3 mil. € dhe shtetet e tjera të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela 4: Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve, në '000 €

Shtetet	2017	2018
Shqipëri	21,271	21,336
Gjermani	8,105	8,275
Maqedoni	7,207	7,969
Serbi	5,268	6,287
Zvicër	1,927	1,826
Bullgari	1,491	1,767
B. Hercegovinë	1,503	1,611
Mali i Zi	1,448	1,559
Kroaci	1,077	1,445
Austri	1,269	1,319
Të tjera	10,770	10,557
Gjithsej	**61,336**	**63,950**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 5: Eksporti për produktet bujqësore sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.2.2 Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve

Shteti prej nga është importuar më së tepërmi në vitin 2018 është Serbia që kishte vlerë 150 mil. €, pasuar nga Gjermania dhe Turqia me vlerë të importit 49.9 mil. € dhe 49.6 mil. € respektivisht, Polonia 47.9 mil. €, Brazili 46.7 mil. €, Maqedonia 45.4 mil. € dhe Italia 40.1 mil. €.

Importi në vlerë më të madhe ka qenë nga grupimi i shteteve si "Të tjera" që kishte vlerë 205.7 mil. €. Me vlerë më të vogël të importit nga shtetet e prezantuara në tabelë ishte Shqipëria me 21.0 mil. €.

Tabela 5: Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve, në '000 €

Shtetet	2017	2018
Serbi	168,422	150,015
Gjermani	50,358	49,850
Turqi	44,489	49,616
Poloni	43,970	47,880
Brazil	45,324	46,652
Maqedoni	42,189	45,442
Itali	35,865	40,120
Kroaci	26,757	30,099
Slloveni	23,551	25,927
Shqipëri	20,357	21,033
Të tjera	193,234	205,680
Gjithsej	**694,517**	**712,314**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 6: Importi për produktet bujqësore sipas shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.3 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve

1.3.1 Eksporti i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve

Vlera më e lartë e eksportit sipas grupeve të shteteve është tek vendet e CEFTA-s në vlerë prej 38.8 mil. € apo 60% të vlerës së eksportit, vendet e BE-së me 20.9 mil. € apo 33% dhe vendet e tjera me 4.3 mil. € apo 7%.

Tabela 6: Eksporti i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, në '000 €

	2014	2015	2016	2017	2018
BE	10,175	10,530	11,910	20,077	20,892
CEFTA	25,601	26,939	29,258	36,697	38,762
Të tjera	3,583	4,214	4,037	4,563	4,296
Gjithsej	**39,359**	**41,683**	**45,205**	**61,336**	**63,950**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 7: Eksporti për produktet bujqësore sipas grupeve të shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve të CEFTA-s

Bazuar në të dhënat e shkëmbimit tregtar të Kosovës me shtetet anëtare të CEFTA-s vërejmë se vlera më e madhe e eksportit ishte në Shqipëri me 21.3 mil. €, pasuar nga Maqedonia ku u eksportuan produkte bujqësore në vlerë prej 8 mil. €. Në Serbi ka pasur eksport në vlerë prej 6.3 mil. €, dhe në B. Hercegovinë dhe Mal të Zi vlera e eksportit ishte nga 1.6 mil. € në secilin shtet.

Tabela 7: Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve të CEFTA-s, në '000 €

Shtetet	2014	2015	2016	2017	2018
B. Hercegovinë	996	916	1,138	1,503	1,611
Mali i Zi	1,378	1,307	1,388	1,448	1,559
Maqedoni	5,743	6,211	5,186	7,207	7,969
Moldavi	-	-	-	-	-
Serbi	3,425	4,532	4,677	5,268	6,287
Shqipëri	14,059	13,973	16,870	21,271	21,336
Gjithsej	**25,601**	**26,939**	**29,258**	**36,697**	**38,762**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve të BE-së

Nga vendet e BE-së vlerë më të madhe të eksportit kanë pasur produktet bujqësore që janë eksportuar në Gjermani ku është arrit vlerë prej 8.3 mil. €, pasuar nga Bullgaria 1.8 mil. €, Kroacia 1.4 mil. €, Austria dhe Rumania me nga 1.3 mil. € dhe shtete tjera të prezantuara në tabelë ku vërehet se eksporti kishte vlerë më të vogël.

Tabela 8: Eksporti i produkteve bujqësore sipas shteteve të BE-së, në '000 €

Shtetet	2014	2015	2016	2017	2018
Gjermani	2,586	2,853	3,157	8,105	8,275
Bullgari	471	734	913	1,491	1,767
Kroaci	1,668	1,839	1,562	1,077	1,445
Austri	924	1,366	814	1,269	1,319
Rumani	363	743	889	1,492	1,289
Suedi	599	554	766	978	1,231
Itali	1,446	900	1,166	1,235	1,079
Holandë	512	389	666	1,087	1,028
Mbretëria e Bashkuar	10	41	327	658	906
Hungari	54	198	252	1,181	757
Të tjera	1,542	913	1,397	1,505	1,797
Gjithsej	**10,175**	**10,530**	**11,910**	**20,077**	**20,892**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Eksporti i produkteve bujqësore për shtetet tjera (jashtë BE-së dhe CEFTA-s)

Vlera e eksportit në shtetet tjera jashtë BE-së dhe CEFTA-s ka qenë mjaft e vogël. Vendet ku eksporti paraqitet në vlerë më të madhe ishte Zvicra me 1.8 mil. € dhe konsiderohet si vlerë më e lartë nga ky grupim i shteteve, duke vazhduar me shtetet tjera që janë të prezantuara në tabelë e që vlera e produkteve bujqësore ishte mjaft e vogël, duke filluar nga 0.1 deri në 0.7 mil. €

Tabela 9: Eksporti i produkteve bujqësore për shtetet tjera jashtë (BE-së dhe CEFTA-s), në '000 €

	2014	2015	2016	2017	2018
Zvicër	703	1,010	1,211	1,927	1,826
SHBA	194	91	188	297	561
Irak	249	186	177	437	240
Libi	354	373	120	-	222
Turqi	27	-	22	129	214
Katar	104	154	127	153	112
Emiratet e Bashkuara Arabe	156	257	302	278	112
Singapor	-	-	-	-	102
Indi	-	33	25	-	90
Kolumbi	43	48	79	94	81
Të tjera	1,753	2,061	1,786	1,248	736
Gjithsej	**3,583**	**4,214**	**4,037**	**4,563**	**4,296**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.3.2 Importi i produkteve bujqësore sipas gruperve të shteteve

Në vitin 2018 vlerë më e madhe e importit të produkteve bujqësore vjen nga vendet e BE-së me vlerë 301.1 mil. €, që ka pjesëmarrje në import 42%, vijuar nga vendet e CEFTA-s me vlerë prej 239.2 mil. €, me pjesëmarrje prej 34% dhe vendet "Të tjera" nga të cilat shtete është importuar 172 mil. € me pjesëmarrje prej 14% të vlerës së importit të produkteve bujqësore.

Tabela 10: Importi i produkteve bujqësore sipas grupeve të shteteve, në '000 €

	2014	2015	2016	2017	2018
BE	249,015	249,010	262,402	275,846	301,119
CEFTA	227,141	240,000	248,550	258,444	239,244
Të tjera	139,962	144,692	147,779	160,227	171,952
Gjithsej	**616,118**	**633,702**	**658,730**	**694,517**	**712,314**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 8: Importi për produktet bujqësore sipas grupeve të shteteve



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve të CEFTA-s

Shteti prej nga ka pasur vlerë më të madhe të importit të produkteve bujqësore në vitin 2018 ka qenë Serbia 150 mil. €, Maqedonia 45.4 mil. €, Shqipëria 21 mil. €, B. Hercegovina 18.7 mil. €, Mali i Zi 3.9 mil. € dhe Moldavia 0.2 mil. €.

Tabela 11: Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve të CEFTA-s, në '000 €

	2014	2015	2016	2017	2018
B. Hercegovinë	16,481	21,637	22,922	24,103	18,719
Mali i Zi	3,304	3,293	3,348	3,280	3,865
Maqedoni	39,132	38,420	40,635	42,189	45,442
Moldavi	111	82	108	92	172
Serbi	153,712	158,033	162,683	168,422	150,015
Shqipëri	14,400	18,534	18,853	20,357	21,033
Gjithsej	**227,141**	**240,000**	**248,550**	**258,444**	**239,244**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve të BE-së

Importi në vlerë më të madhe në vitin 2018 nga vendet e BE-së ishte nga Gjermania në vlerë prej 49.9 mil. €, Polonia 47.9 mil. €, Italia 40.1 mil. €, Kroacia 30.1 mil. €, Sllovenia 25.9 mil. €, Austria 18.8 mil. €, Bullgaria 14.8 mil. €, Greqia 14.0 mil. €, Holanda 12.4 mil. € dhe Hungaria 12.3 mil. €. Ndërsa vlera e importit nga shtetet tjera të BE-së të grupuara si "Të tjera" ishte 34.9 mil. €.

Tabela 12: Importi i produkteve bujqësore sipas shteteve të BE-së, në '000 €

	2014	2015	2016	2017	2018
Gjermani	45,457	45,714	54,235	50,358	49,850
Poloni	28,782	43,484	43,000	43,970	47,880
Itali	27,239	30,760	31,910	35,865	40,120
Kroaci	24,579	22,144	24,330	26,757	30,099
Slloveni	25,795	23,403	23,313	23,551	25,927
Austri	15,329	14,954	14,849	16,420	18,847
Bullgari	16,658	14,819	12,210	13,471	14,803
Greqi	12,657	11,350	13,608	12,980	13,972
Holandë	19,732	9,051	9,530	11,246	12,420
Hungari	11,131	8,680	9,267	10,241	12,292
Të tjera	21,656	24,651	26,151	30,986	34,908
Gjithsej	**249,015**	**249,010**	**262,402**	**275,846**	**301,119**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Importi i produkteve bujqësore për shtetet tjera (jashtë BE-së dhe CEFTA-s)

Në vitin 2018 importi më i madh nga vendet tjera (jashtë BE-së dhe CEFTA-s) paraqitet të jetë nga Turqia në vlerë prej 49.6 mil. €, pasuar nga Brazili 46.6 mil. €, Zvicra 13.9 mil. €, Shtetet e Bashkuara të Amerikës 8.1 mil. € si dhe vendet tjera që janë shfaqur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 13: Importi i produkteve bujqësore për shtetet tjera (jashtë BE-së dhe CEFTA-s), në '000 €

	2014	2015	2016	2017	2018
Turqi	36,800	36,510	42,209	44,489	49,616
Brazil	38,965	37,362	36,598	45,324	46,652
Zvicër	2,025	1,391	1,659	5,906	13,931
Shtetet e Bashkuara të Amerikës	13,845	12,183	11,671	8,622	8,101
Shiri Lankë	7,350	8,822	7,048	9,187	7,984
Ekuador	5,129	4,070	6,098	4,802	6,251
Indi	1,069	1,838	2,299	4,501	5,176
Kinë	4,522	5,038	3,881	4,511	4,377
Argjentinë	2,945	2,663	3,065	2,954	3,309
Kirgistan	3,061	3,391	2,513	3,071	3,031
Të tjera	24,252	31,424	30,739	26,859	23,523
Gjithsej	**139,962**	**144,692**	**147,779**	**160,227**	**171,952**

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.3.3 Bilanci tregtar sipas grupeve të shteteve

Në vitin 2018 importi i produkteve bujqësore nga vendet e BE-së ishte 301.1 mil. €, eksporti 20.9 mil. €, ku paraqitet një bilanc tregtar negativ në vlerë 280.2 mil. €.

Nga grupi i vendeve të CEFTA-s në vitin 2018, importi ishte 239.2 mil. €, eksporti 38.8 mil. € ku rrjedhimisht edhe në këtë grup të shteteve paraqitet bilanc tregtar negativ në vlerë prej 200.5 mil. €.

Importi i produkteve bujqësore nga vendet e tjera jashtë BE-së dhe CEFTA-s në vitin 2018 ishte në vlerë 172 mil. €, kurse eksporti shënoi vlerën 4.6 mil. €, kështu që bilanci tregtar ishte gjithashtu negativ në vlerë prej 167.6 mil. €.

Figura 9: Importi, Eksporti dhe Bilanci tregtar për produktet bujqësore sipas grupeve të shteteve 2017 (majtas) dhe 2018 (djathtas), në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.4 Produktet bujqësore (kapitujt) më të eksportuara dhe importuara

1.4.1 Kapitujt që kanë pasur vlerë më të madhe të eksportit në vitin 2018

Kur bëhet fjalë lidhur me produktet më të eksportuara sipas kapitujve vërejmë se në vitin 2018 vlerë më të madhe kishin produktet nga kapitulli 22 (27.6 mil. €), pasuar nga produktet e eksportuara nga kapitulli 08 në vlerë prej 8.8 mil. €.

Eksporti nga tre kapitujt tjerë kishte vlerë 5.6 mil. € nga kapitulli 07, 4.5 mil € nga kapitulli 20 si dhe 4 mil € për produktet e eksportuara nga kapitulli 09.

Figura 10: Eksporti për 5 kapitujt që kanë pasur vlerë më të madhe në vitin 2018, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.4.2 Kapitujt që kanë pasur vlerë më të madhe të importit në vitin 2018

Më së shumti janë importuar produktet nga kapitulli 22 në vlerë 77.1 mil €, kapitulli 21 (68.1 mil €), dhe kapitujt 02, 24, 19 që kishin vlerë 64.9 mil €, 64.8 mil €, si dhe 64.6 mil €, respektivisht. Të prezantuara në figurë janë edhe kapitujt e tjerë që kishin vlerë nga 47.7 mil € deri 28.3 mil €.

Figura 11: Importi për 10 kapitujt që kanë pasur vlerë më të madhe në vitin 2018, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.5 Eksporti dhe importi i produkteve bujqësore për secilin kapitull sipas viteve

1.5.1 Eksporti dhe importi për "Kafshët e gjalla" (kapitulli 01)

Vlera e eksportit për kafshët e gjalla në vitin 2018 ka qenë shumë e vogël (0.02 mil. €), ndërsa vlera e importit ishte 15.5 mil. €, që paraqet edhe vlerën më të madhe për këtë kategori për periudhën 2014-2018. Vlera më e vogël e importit është shënuar në vitin 2016 ku kjo vlerë ishte 7.9 mil. €. Në vitin 2017 kishte rritje të vlerës së importit në 10.9 mil. €, duke vazhduar me 15.5 mil € në 2018 apo 42% më e lartë sesa në vitin 2017.

Tabela 14: Eksporti dhe importi për kapitullin 01, në '000 €

Vitet	Eksporti	Importi
2014	0.2	12,201
2015	0	9,525
2016	0	7,930
2017	0	10,873
2018	16.5	15,502

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 12: Eksporti (majtas) dhe importi (djathtas) për kapitullin 01, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 13: Importi për kapitullin 01 sipas shteteve, në 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZH

1.5.2 Eksporti dhe importi për "Mishin dhe të brendshmet e ngrënshme të kafshëve" (kapitulli 02)

Edhe pse vlera e eksportuar e mishit ishte në sasi mjaft të vogël, mund të thuhet se eksporti më i madh ishte në vitin 2016, në vlerë prej 0.2 mil. €, ndërsa në vitin 2018 kjo vlerë ishte 0.1 mil. €. Përkundër eksportit shumë të vogël, vlera e importit është rritur përgjatë periudhës 2014-2018. Në vitin 2018 vlera e produkteve të importuara nga ky kapitull ishte 64.9 mil. €, ku paraqitet edhe si vlerë më e madhe për periudhën 2014-2018, që në krahasim me vlerën e vitit 2017 pati rritje 4.7%.

Tabela 15: Eksporti dhe importi për kapitullin 02, në '000 €

Vitet	Eksporti	Importi
2014	109	62,040
2015	175	61,758
2016	248	57,848
2017	183	61,986
2018	127	64,878

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 14: Eksporti (majtas) dhe importi (djathtas) për kapitullin 02, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 15: Eksporti (majtas) dhe importi (djathtas) për kapitullin 02 sipas shteteve, në 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.5.3 Eksporti dhe importi për "Peshqit dhe krustacet, molusqet dhe kafshët e tjera jokurrizore ujore" (kapitulli 03)

Eksporti i peshkut, krustaceve, molusqeve dhe kafshëve tjera jokurrizore ujore ka qenë shumë i vogël. Në vitin 2014 nuk ka pasur fare eksport, përderisa eksporti i vitit 2015 dhe 2016 kishte vlerë 0.03 dhe 0.04 mil. €, respektivisht. Në vitin 2017 vlera e eksportit ishte 0.17 mil. €, ndërsa në vitin 2018 kjo vlerë e eksportit ishte 0.11 mil. €, që paraqet rënie në vlerë për 36.1% në krahasim me vitin 2017.

Vlera më e vogël e importit ka qenë në vitin 2014 rreth 2 mil. €, deri sa në vitet 2015, 2016, dhe 2017 kjo vlerë arriti në mbi 2 mil. €. Në vitin 2018 vlera e importit të produkteve nga ky kapitull ishte 3 mil. €.

Tabela 16: Eksporti dhe importi për kapitullin 03, në '000 €

Vitet	Eksporti	Importi
2014	-	1,959
2015	32	2,292
2016	37	2,120
2017	172	2,640
2018	110	2,999

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 16: Eksporti (majtas) dhe importi (djathtas) për kapitullin 03, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 17: Eksporti (majtas) dhe importi (djathtas) për kapitullin 03 sipas shteteve, në 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZH

1.5.4 Eksporti dhe importi për "Produkte të qumështit; vezët; mjalti natyral; produkte të ngrënshme me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër" (kapitulli 04)

Gjatë analizimit të vlerës së eksportit të këtyre produkteve vihet re shtim i lehtë i eksportit. Produktet e eksportuara nga ky kapitull kanë pasur vlerë shumë të vogël, duke filluar nga viti 2014 kur vlera e eksportit ishte 0.2 mil. €, vijuar nga vitet tjera ku paraqitet vlera e eksportit 0.5 mil. €.

Në vitin 2014 vlera e importit ishte 38.3 mil. € ndërsa në vitin 2015 ishte 37.8 mil. €, pasuar me një trend të rritjes së vazhdueshme deri në vitin 2018 ku vlera e importit të këtyre produkteve ishte 47.7 mil. €, që në krahasim me vitin 2017 pati një rritje prej 5.8%.

Tabela 17: Eksporti dhe importi për kapitullin 04, në '000 €

Viti	Eksport	Import
2014	200	38,309
2015	459	37,750
2016	490	41,475
2017	492	45,069
2018	471	47,672

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 18: Eksporti (majtas) dhe importi (djathtas) për kapitullin 04, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 19: Eksporti (majtas) dhe importi (djathtas) për kapitullin 04 sipas shteteve, në 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.5.5 Eksporti dhe importi për "Produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër" (kapitulli 05)

Për produktet nga kapitulli 05 ku janë të përfshira produkte me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër nuk ka pasur fare eksport.

Importi i produkteve me origjinë shtazore, të pa përfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër nuk ka pasur vlerë të madhe dhe është karakterizuar me rënie dhe ngritje të lehta në vlerë të importit në periudhën 2014-2018. Vlera më e vogël e importit ishte 0.5 mil. €, ndërsa më e madhja ishte në vitin 2018, me vlerë 1 mil. €.

Tabela 18: Eksporti dhe importi për kapitullin 05, në '000 €

Viti	Eksport	Import
2014	0	815
2015	0	647
2016	0	521
2017	0	915
2018	0	986

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 20: Importi për kapitullin 05, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 21: Importi për kapitullin 05 sipas shteteve, në 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.5.6 Eksporti dhe importi për "Drunjtë dhe bimët e tjera; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashme; lulet e prera dhe gjethet dekorative" (kapitulli 06)

Vlera e eksportit të produkteve nga ky kapitull ka shënuar rritje të ngadalshme, duke filluar nga viti 2017, që ka vazhduar me rritje edhe në vitin 2018, ku vlera eksportit të produkteve nga ky kapitull ishte 0.2 mil. €, dhe ishte vlera më e lartë e arritur në periudhën 2014-2018.

Vlera e importit në vitin 2014 ishte 2.7 mil. €, vijuar me rritje në vitin 2015 në vlerë prej 4.5 mil. €. Vlerë më e lartë e importit ishte në vitin 2016 me 5.2 mil. €, ndërsa në vitin 2017 dhe 2018 u shënuan vlerat 4.8 mil. € dhe 4.5 mil. €.

Tabela 19: Eksporti dhe importi për kapitullin 06, në '000 €

Viti	Eksport	Import
2014	22	2,691
2015	41	4,493
2016	58	5,233
2017	165	4,847
2018	226	4,566

Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 22: Eksporti (majtas) dhe importi (djathtas) për kapitullin 06, në '000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Figura 23: Eksporti (majtas) dhe importi (djathtas) për kapitulli 06 sipas shteteve, në 2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

1.5.7 Eksporti dhe importi për "Perimet e ngrënshme dhe disa lloje të rrënjëve dhe zhardhokëve" (kapitulli 07)

